

- Kohëzgjatja e praktikës:** Nga një (1) deri në tre (3) muaj (varësisht prej kërkesës së studentëve)
- Njohuritë të cilat përfitohen:** Kontakti dhe komunikimi me konsumatorë, pranimi në sportel i dërgesave postare, dërgimi i mbushjeve elektronike, kryerja e pagesave të ndryshme (faturat e telefonit, internetit, rrymës, ujit, taksat e ndryshme), etj.
- Lokacionet / zyrat postare ku mund të vijohet praktika:**
- Gjilan** (3 zyra postare): Posta kryesore; Posta e vogël (afër Universitetit “Kadri Zeka”); Posta tek Stacioni i Autobusëve
- Viti** (1 zyre postare): Posta kryesore në Viti
- Kamenicë** (1 zyre postare): Posta kryesore në Kamenicë
- Kapaciteti për vijim të praktikës:** Në të gjitha zyrat postare të cekura, përnjëherë mund të vijojnë praktikën më së shumti 10 praktikantë (Gjilan: 6 praktikantë; Viti: 2 praktikantë; Kamenicë: 2 praktikantë)
- Orari i vijimit të praktikës:** E Hënë – e Premte, orari nga 6.5 orë në ditë.
- Ndërrimet e punës:** 08:00 – 14:30 dhe 12:30 – 19:00 (gjatë stinës së Verës punohet deri në orën 21:00)
- Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:**
- 1) Formulari i Kërkesës (plotësohet në zyrat tona)
 - 2) Kopja e Letërnjoftimit të studentit
 - 3) Vërtetimi nga Universiteti, për statusin e studentit
- Aprovimi i kërkesave për praktikë:** Kërkesat për praktikë dorëzohen në Postën kryesore në Gjilan, ndërsa aprovimi i tyre bëhet nga Kryeshefi Ekzekutiv i Postës në Prishtinë, brenda një jave pas dorëzimit të dokumentacionit nga ana e studentëve.

- Pas përfundimit të praktikës, studentët marrin Vërtetimin përkates si dëshmi për vijimin e praktikës.